



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Nr. 6 prot
Dt. 28/02/2023

VENDIM

Nr. 5, datë 23.02.2023

PËR

**SAKTËSIMIN E KUOTËS (Z) TË VENDNDODHJES SË
PUSHPIMIT DHE MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES
ME NR.353/1 PROT., DATË 18.09.2017,
TË SUBJEKTIT "MEDAUR" SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Saktësimin e koordinatës Z të vendndodhjes së pus-shpimit të lejes me Nr.353/1 prot., datë 18.09.2017, miratuar me vendimin nr.2, datë 05.09.2017 nga Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë si më poshtë:

a) Koordinata Z e vendndodhjes së pus-shpimit do të saktësohet si mëposhtë:

Nga:

- X= 452680.2; Y = 4675260.8; Z = 20.8 m.m.n.d. (KRGJSH)

Në:

- X= 452680; Y = 4675261; Z = 51 m.m.n.d. (KRGJSH)

2. Miratimin e rinovimit të lejes me koordinatën Z të vendndodhjes së pusshpimit të saktësuar si më sipër, për përdorim burimi ujqor nëntokësor për qëllime sanitare me Nr.353/1 prot., datë 18.09.2017, miratuar nga KBU Drinë-Bunë me vendimin Nr.2, datë 05.09.2017 të subjektit "MEDAUR" sh.p.k, me vendndodhje: Njësia Administrative Koplík, Bashkia Malësi e Madhe, Qarku Shkodër.

Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e pus-shpimit (KRGJSH):

-X = 452680; Y = 4675261; Z = 51 m.m.n.d.

Lloji i aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: Për qëllime sanitare (në kantinën e prodhimit të verës të subjektit "MEDAUR" sh.p.k).

Sasia e ujit që jepet për përdorim: $Q=0.0035 \text{ m}^3/\text{sek}$

Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorura: Në rrjetin e kanalizimeve.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

